Kronikë

Atentati ndaj policit e kunatit në Shkodër, gjenden 3 kallashnikovë! Dëshmia: U fshehëm pas makinës! Autorët dyshohet se ishin 4

Vjojnë hetimet për atentatin që tronditi mbrëmjen e djeshme qytetin e Shkodrës. Polici Gjergj Ndershtiqaj, vëllai i Marjan Ndershtiqaj drejtor i Transportit Rrugor në këtë qytet dhe kunati i tij Gjin Nika, në dëshminë dhënë para hetuesve, kanë deklaruar se nuk i kanë parë se kush i qëlloi dhe se nuk kanë konflikte. 3 kallashnikovë u gjetën në makinën e djegur, ndërsa autorët dyshohet se ishin 2.

- Atentat në Shkodër, plagoset vëllai i drejtorit të DRSHTRR e kunati (EMRAT-VIDEO)
- VIDEO/ Hetuesit marrin provat, breshëria e plumbave

Gjergj Ndershtiqaj, dhe ekspertët në vendin e ngjarjes

Redaksia
13 Mars, 08:47 | **Përditesimi: 13 Mars, 11:09**

Share

SHKODËR- Qyteti i Shkodrës u trondit mbrëmjen e 12 marsit 2024 ***nga një atentat***, ku për pasojë mbetën të plagosur dy persona, kunetër mes tyre, ndërsa i pranishëm ishte edhe një person i tretë (i pa lënduar). Dyshohet se shënjestra ka qenë Gjon Nika, kunati i studentit të Akademisë së Sigurisë, Gjergj Ndershtiqaj. Ky i fundit është vëllai i Marjan Ndershtiqaj drejtor i Drejtorisë Rajonale të Sherbimeve të Transportit Rrugor (DRSHTRR) në Shkodër. Nuk dihen ende motivet e kësaj ngjarje të rëndë.

Autorët dyshohet se kanë djegur dy automjete, të tyrin dhe të të plagosurve. Report TV ka arritur të sigurojë dëshmitë e dy të plagosurve nga ky atentat.

> *"Sapo zbritëm nga makina dëgjuam të shtëna armësh. Nuk kemi arritur që të shohim se kush ishin ata që na qëlluan me armë. Nuk kemi konflikte me persona të tjerë dhe nuk e dimë arsyen përse na qëlluan. Në momentin kur nisën të shtënat kemi lëvizur me shpejtësi duke u munduar të shpëtojmë. Derisa janë larguar qëndruam pas makinës.", thanë të plagosurit përpara hetuesve.*

LEXO EDHE:
Atentat në Shkodër, qëllohet drejt vëllait të drejtorit të DRSHTRR e kunatit, digjet makina e të plagosurve dhe e autorëve (EMRAT-VIDEO)

Policia ka shoqëruar 20 persona deri më tani, të cilët dyshohet se mund të kenë dijeni për ngjarjen. Grupi hetimor, ka gjetur në vendin e ngjarjes 80 gëzhoja automatiku, të cilat janë përdorur nga autorët.

Mësohet se kanë qenë 2 autorë, të cilët kanë qëlluar në drejtim të të rinjve. Armët e autorëve janë gjetur në makinën e djegur, e cila është transportuar në policinë e Shkodrës për ekspertim më të specializuar. Po ashtu nga flakët është përfshirë edhe makina e dy të plagosurve e cila dyshohet se ka marrë flakë si pasojë e të shtëna ve me armë zjarri.

Nga kamerat e sigurisë së lokalit në afërsi të të cilit ndodhi ngjarja nuk kanë arritur të shihen autorët, ndërkohë që dyshohet se autorët kanë qenë të maskuar.

Dy të plagosurit kanë marrë nga një plumb në trup duke arritur t'i shpëtojnë mrekullisht morisë së plumbave dhe aktualisht ndodhen në spital.

*Lajm në përditësim...

M.Q./Shqiptarja.com

TAG: Shkodër | Gjergj Ndershtiqaj | atentat | Marjan Ndershtiqaj | gjon nika

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
'21 janari' do të hetohet nga SPAK, besoni se do bëhet drejtësi?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Grabiti një makinë dhe çantën brenda një automjeti tjetër, arrestohet 38 vjeçari në Shkodër
12 Mars, 15:56

VIDEO/ Qafë Thore - Theth, mjetet në punë për pastrimin e rrugës! Në disa akse dhe rënie gurësh e inertesh
12 Mars, 12:20

Amnistia penale, 200 të dënuar në burgun e Reçit letër deputetëve: Lini pas ndasitë, votoni pro
12 Mars, 09:45

Rama: PS sjell zhvillim, partitë e tjera vetëm rrëmujë! Kaosi dhe pengmarrja e Kuvendit bëhet për interesa personale, jo për qytetarët
11 Mars, 19:22

Reshje dëbore në aksin Bogë-Qafë Thore, qarkullimi kryhet pa probleme
11 Mars, 14:02

'Duam bust të Lekë Dukagjinit', protestë para Bashkisë Shkodër! Benet Beci: Dera e hapur, do gjejmë zgjidhjen
11 Mars, 12:05

Digjet një makinë e parkuar në Shkodër
10 Mars, 22:49

Berisha ende s'e ka kuptuar përse e ka humbur Shkodrën
Mero Baze
10 Mars, 21:52

Kryebashkiaku i Berishës në mbledhjen e Ramës, Dodaj: Takim i frytshëm! Duam përkrahje, jo të jemi 'delja e zezë'! Kërkova investime për Pukën
10 Mars, 17:45

Veri Jug - Fytyra e historisë në Gurin e Zi në Shkodër
Agim Pipa
10 Mars, 16:52

Rama takim me strukturat: Shkodra peng i së shkuarës, demokratët e kanë derën e hapur! Aktivizohuni në rrjetet sociale
10 Mars, 14:19

Rama inspektime në Shkodër: Po s'e bam ne, kush tjetër harroje se e ban sa jena gjallë! Treg dhe konvikt i ri
10 Mars, 13:24

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje